



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

12.12.2018

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

shpall

NJOFTIM PUBLIK

Për angazhimin e ekspertëve të fushave funksionale në programet trajnuese dhe arsimore

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, me qëllim të zbatimit të programeve trajnuese dhe arsimore benë azhurnimin e listës zyrtare (bazës së të dhënave) të eksperteve të jashtëm.

Azhurnimi i bazës së të dhënave behët duke angazhuar ekspert të fushave funksionale, si në vijim:

1. Prokuror i shtetit (departamenti i përgjithshëm);
2. Prokuror i shtetit (departamenti i krimeve të rënda);
3. Gjyqtar (departamenti për të mitur);
4. Ekspert nga fusha e Mjekësisë Ligjore;
5. Ekspert nga fusha e komunikacionit;
6. Ekspert nga fusha e psikiatrisë;
7. Ekspert nga fusha e rrezatimit bërthamor dhe radiologjik;
8. Ekspert nga fusha e luftimit të korrupsionit dhe ndërgjegjësimit;

Kandidatet që shprehin interesim për angazhim duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të kenë të përfunduar studimet universitare;
2. Të jenë të punësuar dhe të kenë përvojë në fushat përkatëse;
3. Aftësi profesionale që rrjedhin nga njohuria e lëndës;
4. Të ketë shkathtësi të larta komunikuese dhe organizative;

Kandidatet e interesuar duhet t'i dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- Kërkesën me biografi (CV);
- Ekstraktin e lindjes apo kopjen e letërnjoftimit;

- Kopjen e diplomës universitare;
- Kopjet e trajnimeve të kryera;
- Dëshmitë mbi përvojën e punës në fushën përkatëse, si dhe informata tjera specifike shtesë, të cilat konsiderohen të rëndësishme për kandidatin që aplikon.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike -Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, zyra nr. 01. Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara, pa dëshmi).

Mundësia për aplikim mbetet e hapur 8 (tetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes së njoftimit publik, respektivisht deri me datën 19.12.2018, në ora 16:00.

Brenda 7 (shtatë) dite nga data e mbylljes së njoftimit publik, Komisioni i emëruar nga Akademia, do të përzgjedh me se shumti nga 3 (tre) ekspert që i plotësojnë më së miri kushtet nga secila fushe e kërkuar. Të njëjtit bëhen pjesë e listës zyrtare (bazës së të dhënave) dhe ftohen për angazhim në programe trajnuese sipas radhës të renditur në listë dhe varësisht nga nevojat e Akademisë.

Angazhimi nuk nënkupton themelimi i marrëdhënies së punës. Kontrata lidhet sipas dispozitave të aplikueshëm që rregullon ofrimin e shërbimeve të veçanta apo punën me honorar me ç' rast kompensohet vetëm dita që angazhohet eksperti.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike, ofron mundësi të barabartë për gjithë kandidatet e interesuar, andaj inkurajohen të aplikojnë kandidatet me ekspertizë në fushat e kërkuara.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Divizionin për Burime Njerëzore, në numrin e tel: 028 590 070 lok.210 apo 211, ç' do ditë pune prej orës 08:00-16:00.